



VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 20 mars 2012

Nr. i lëndës 2011-23

Z. Hashim Rexhepi

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 20 mars 2012, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare e Panelit
Znj. Verginia MICHEVA-RUSEVA, anëtare e Panelit

Ndihmuar nga:

Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llëgaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Kjo ankesë është regjistruar më 8 korrik 2011.

II. FAKTET

2. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi i ankesës, dhe siç shihen prej dokumenteve në dispozicion të Panelit, mund të përmbliidhen si në vijim.

Historiku

3. Më 21 korrik 2010 Zyra e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës (ZPSK) ka parashtruar një kërkesë për aktvendim mbi nisjen e një hetimi kundër parashtruesit të ankesës dhe të tjerëve.
4. Më 22 korrik 2010 ishte lëshuar një urdhër arresti nga një gjykatës i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës për ta autorizuar bastisjen e zyrave të punës së parashtruesit të ankesës në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) në Prishtinë, banesës private të parashtruesit të ankesës dhe lokaleve të biznesit të kompanisë private "Crea-Co".
5. Bastisja ishte kryer në të njëjtën ditë nga njësi speciale e policisë së Kosovës kundër Korrupsionit (Njësi e PK).
6. Atë ditë me vonë, parashtruesi i ankesës ishte arrestuar në BQK nga njësi e PK-së, në bazë të një urdhër arresti të lëshuar nga ZPSK me datën 22 korrik 2010. Ai dyshohej të ketë kryer shumë pika të keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe autoritetit (5 pika), ushtrim i ndikimit (3 pika), shpëlarje të parave, evazion fiskal dhe marrje të mitos (secila nga 1 pikë).

Paraburgimi

7. Më 24 korrik 2010, gjykatësi i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës ka vendosur parashtruesin e ankesës në paraburgim për një periudhë prej një (1) muaji, e që skadonte më 23 gusht 2010.
8. Ky aktvendim më pas ishte vërtetuar nga një trup gjykues prej tre gjykatësve në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës më 27 korrik 2010.
9. Në të njëjtën ditë, ZPSK ka vazhduar hetimin për të përfshirë një akuzë shtesë për keqpërdorim të pozitës zyrtare.
10. Më 16 gusht 2010, avokati mbrojtës ka parashtruar një propozim të ri për heqjen e paraburgimit. Kjo kërkesë u hodh poshtë nga gjykatësi i procedurës paraprake në një datë të mëvonshme, e cila nuk është dhënë.
11. Më 17 gusht 2010, prokurori publik ka parashtruar në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës një propozim për vazhdimin e paraburgimit, duke deklaruar *mes të tjerash*, se aty kishte dyshim të bazuar se ai do të ikte nga ndjekja penale nëse ai do të lirohej. Avokati mbrojtës ka kundërshtuar këtë kërkesë.
12. Më 20 gusht 2010, ky paraburgim ishte vazhduar edhe për dy (2) muaj deri më 23 tetor 2010 nga një trup gjykues prej tre gjykatësve në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, me dyshimin se parashtruesi i ankesës në bashkëpunim me të tjerët kishte kryer vepra penale të saktësuara më lart (shih paragrafin 6 më lart).

13. Avokati mbrojtës ka kërkuar një rishikim të paraburgimin të parashtruesit të ankesës nga ana e Kryetarit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it më 6 shtator 2010.
14. Më 14 shtator 2010, avokati mbrojtës ka kërkuar nga kryeprokurori i EULEX-it, në përputhje me nenin 286 (2) të Kodit Penal të Kosovës (KPK), për të shqyrtuar ligjshmërinë e paraburgimit të parashtruesit të ankesës.
15. Kryeprokurori i EULEX-it është përgjigjur më 15 shtator 2010 se Gjykata Supreme tashmë e kishte vërtetuar ligjshmërinë e vendimit për të mbajtur parashtruesin e ankesës në paraburgim më 26 gusht 2010 dhe si rezultat ajo nuk mund të shqyrtohet. Parashtruesi i ankesës më tej ishte njoftuar se Gjykata Supreme kishte vendosur një afat për prokurorinë deri më datën 23 tetor 2010 që të paraqiste prova për të vërtetuar akuzat. Pas asaj date, urdhri për paraburgimin e parashtruesit të ankesës mund të hiqej në bazë të provës që duhej të parashtrohej nga prokuroria.
16. Një propozim tjetër për përcaktimin e ligjshmërisë së paraburgimit të parashtruesit të ankesës ishte hedhur poshtë nga gjykatësi i procedurës paraprake më 30 shtator 2010.

Akuzat e reja

17. Më 18 tetor 2010, ZPSK ka bërë një kërkesë për vazhdimin e paraburgimit në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës. Tri aktakuza të reja (Pikat 6 deri në 8) ishin shtuar në atë kërkesë, pra keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit (tre pika) dhe marrja e mitos (tre pika). Paraburgimi ishte vazhduar përmes një vendimi nga gjykatësi i procedurës paraprake më 22 tetor 2010 për një periudhë prej një (1) muaji, që ishte caktuar të skadonte më 23 nëntor 2010.
18. Avokati mbrojtës ka ushtruar ankesë kundër vendimit të datës 22 tetor 2010, mirëpo kjo ankesë ishte hedhur poshtë si e pabazuar nga një trup gjykues prej tre gjykatësve të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës më 26 tetor 2010.
19. Në aktvendimin e tij të datës 26 tetor 2010, trupi gjykues ka deklaruar se: "gjatë seancës dëgjimore për paraburgim me datën 20 tetor 2010, gjykatësi i procedurës paraprake ka vërejtur se akuzat nën Pikat 6 deri në 8 (marrja e mitos) ishin mbështetur vetëm prej letrave anonime të cilat nuk mund të merren si prova që mbështesin këtë propozim".
20. Trupi gjykues i përbërë prej tre gjykatësve gjithashtu ka deklaruar në Aktvendimin e përmendur më lart, duke iu qasur parashtruesit nga ana e parashtruesit të ankesës lidhur me një mos zbulim të pretenduar të provës nga ana e ZPSK se: "Të njëjtën ditë [20 tetor 2010] pas përfundimit të seancës për paraburgim, ZPSK ka paraqitur provë shtesë në mbështetje të akuzave nën Pikën 6 deri në 8 të cilat i ishin bashkuar dosjes së lëndës ... Nuk ka asnjë tregues [] se kjo

provë ishte transmetuar tek mbrojtja [] apo ishte zhvilluar ndonjë seancë tjetër gjyqësore për të shqyrtuar kërkesës për vazhdimin e paraburgimit".

Masat kufizuese

21. Më 15 nëntor 2010, ZPSK ka parashtruar një kërkesë tek Gjykata e Qarkut e Prishtinës për zbatimin e masave kufizuese ndaj parashtruesit të ankesës. Akuzat nën Pikat 6 deri në 8 kanë mbetur në atë kërkesë. Avokati mbrojtës ka kundërshtuar atë.
22. Më 18 nëntor 2010, një gjykatës i procedurës paraprake ka vendosur për t'i zbatuar masat kufizuese. Ndër të tjerash, ishte vendosur që dorëzania në shumën prej 20,000.00 euro të caktohej dhe ai të lirohej nga paraburgimi menjëherë, atëherë kur gjykata të siguronte dëshmi se dorëzania do të paguhej. Akuzat nën Pikat 6 deri në 8 ishin përfshirë në atë Aktvendim.
23. Parashtruesi i ankesës ishte liruar nga paraburgimi me datën 18 nëntor 2010, pasi kishte paguar dorëzaninë që ishte caktuar nga gjykata.
24. Avokati mbrojtës ka kundërshtuar vazhdimin e zbatimit të masave kufizuese më 17 dhjetor 2010.
25. Më 18 janar 2011, ZSPK ka parashtruar një kërkesë tjetër për një vazhdim të hetimit në përputhje me Nenin 225 (1) të KPK. Akuzat nën Pikat 6 deri në 8 ishin vendosur në listë si pjesë e kërkesës përkundër faktit se ato i kishte hequr një gjykatës i procedurës paraprake më 26 tetor 2010 (shih paragrafët 17 deri 20 më lart).
26. Gjykatësi i procedurës paraprake ka konstatuar më 18 janar 2011 se hetimi ndaj parashtruesit të ankesës të vazhdoj edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë deri më 21 korrik 2011. Edhe një herë akuzat nën Pikat 6 deri në 8 ishin përfshirë në aktvendim. Avokati mbrojtës pa sukses ka kundërshtuar këtë vazhdim.

Paraqitja e padisë

27. Më 5 gusht 2011, ZSPK kanë paraqitur padi kundër parashtruesit të ankesës në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës. Akuzat lidhur me Pikat 6 deri në 8 ishin hedhur poshtë. Ai ishte akuzuar lidhur me këto pika të paraqitura në vijim:

Pika 1

- Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit dhe ushtrim i ndikimit: konkretisht parashtruesi i ankesës si zëvendës guvernator i mbikëqyrjes financiare në Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës (AQBK) dhe drejtor mbikëqyrës për kompanitë e sigurimit ka keqpërdorur pozitën e tij zyrtare duke ushtruar ndikim në Asociacionin e Sigurimit të Kosovës (ASK) për të blerë një softuer të caktuar administrativ nga një Kompanisë e TI e quajtur "Crea-K" me një vlerë prej 45,000.00 euro. Kjo kompani ishte në

bashkëpronësi nga djali i parashtruesit të ankesës i quajtur Granit Rexhepi dhe të tjerë.

Pika 2

- Keqpërdorimi i pozitave zyrtare apo autoritetit: konkretisht më 14 prill 2005, parashtruesi i ankesës ka keqpërdorur pozitën e tij si shef mbikëqyrës i AQBK në mënyrë që të sigurojë sponsorizimin nga Banka për Biznes (BpB) për klubin basketbollistik Prishtina në shumën prej 30,000.00 euro. Ky sponsorizim dyshohej të ishte në kundërshtim me një urdhër ndalimi të lëshuar nga AQBK e cila kishte penguar BpB të autorizonte kredi apo transferime të tjera të parave mbi 10,000.00 euro për shkak të përkeqësimit të gjendjes financiare të bankës.

Pika 3

- Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit; konkretisht më 29 dhjetor 2005 parashtruesi i ankesës ka keqpërdorur pozitën e tij si shef mbikëqyrës i AQBK kur ka detyruar BpB t'i lëshonte një kredi në shumën prej 23,000.00 euro për qëllime personale financiare. Kjo kredi ishte në kundërshtim me një urdhër ndalimi lëshuar nga AQBK e cila ndalonte BpB që të autorizonte kredi mbi 10,000.00 euro për shkak të përkeqësimit të gjendjes financiare të bankës.

Pika 4

- Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit, mashtrim dhe ushtrim i ndikimit: konkretisht më 16 korrik 2009 parashtruesi i ankesës si guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës me qëllim të përfitimeve të jashtëligjshme financiare për vete apo për një palë të tretë të emëruar si administrator, Faton Bajramin, për Kompaninë e Sigurimit Dardania. Ky administrator dyshohet se nën udhëzimin dhe ndikimin e parashtruesit të ankesës ka lejuar që shuma prej 1,987,997.19 euro prej fondeve të Kompanisë të fshihej nga xhirrollogaria financiare e kompanisë, edhe pse kjo shumë ishte tërhequr nga disa punëtorë përgjatë një periudhe kohore në një formë parapagimi për nxitjet e kompanive të mundshme në mënyrë që të pranenin të lidhnin kontrata. Ishte konstatuar se këta punëtorë ishin bashkëpunëtorë të ndryshëm të parashtruesit të ankesës. Kjo ka rezultuar gjoja me humbje të mëdha financiare për kompaninë e sigurimit, siç ishte treguar të ketë një bazë më të ulët të kapitalit sesa kishte në fakt, si dhe mashtrimin e Autoriteteve Tatimore të Kosovës rreth të ardhurave nga lëshimi i kredive të tilla.

Pika 5

- Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit dhe ushtrim i ndikimit: konkretisht se parashtruesi i ankesës në cilësinë e tij zyrtare në AQBK si rregullator dhe më vonë si mbikëqyrës, për Rregullimin e Kompanive të Sigurimit, ka ushtruar ndikim në ASK në mënyrë që të merr në punë bashkëpunëtorët e tij të ngushtë

dhe anëtarët e tij të familjes në të gjitha departamentet e ndryshëm brenda kësaj organizate.

Seancë për konfirmim të aktakuzës

28. Më 20 tetor 2011, një seancë për konfirmim ishte mbajtur në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës në prani të parashtruesit të ankesës dhe një të bashkë-pandehuri, avokatëve të tyre mbrojtës dhe prokurorit të ZSPK.
29. Më 12 dhjetor 2011, gjykatësi konfirmues ka vendosur që ajo pjesë e akuzave (pikat 1, 2 dhe 5) duhej të hidhej poshtë, sepse veprimet që dyshohej se ishin kryer nuk përbënin vepra penale. Më tej u konstatua në lidhje me akuzat e saktësuara në pikat 3 dhe 4 se nuk ka pasur prova të mjaftueshme për të mbështetur aktakuzën.

Ankesa kundër Aktvendimit të gjykatësit konfirmues

30. Më 19 dhjetor 2011, prokurori i ZSPK ka paraqitur një ankesë kundër aktvendimit të konfirmuar të datës 12 dhjetor 2011.
31. Më 11 janar 2012, një trup gjykues prej tre gjykatësve në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës ka hedhur poshtë atë ankesë dhe ka konfirmuar vendimin e mëhershëm të gjykatësit konfirmues.

III. ANKESAT

32. Parashtruesi i ankesës pretendon se ka pasur shkelje të shumta të Nenit 5 dhe 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa, 1950).
33. Ankesat e tij janë bazuar kryesisht në:
 - Arrestimin e pretenduar të tij të paligjshëm dhe të pa arsyeshëm nga ana e Njësisë Anti-Korrupcion i Policisë së Kosovës me 21 korrik 2010,
 - Paraburgimin e pretenduar të tij të panevojshëm të urdhëruar nga një gjykatës i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës me 22 korrik 2010 dhe vazhdimin e mëtejshëm të paraburgimit me 20 gusht 2010 dhe 26 tetor 2010,
 - Mos transmetimin të ai i provës shtesë, e cila i ishte bashkangjitur dosjes nga ana e ZRSK me 20 tetor 2010, dhe në të cilën mbështetej prokuroria gjatë procedurave lidhur me paraburgimin e tij, dhe
 - Rivendosjen e akuzave nën Pikat 6 deri në 8, bazuar në letrat anonime si prova, nga ana e ZRSK me 17 janar 2011, pavarësisht se këto Pika ishin përjashtuar përmes vendimeve të mëhershme të datës 22 tetor 2010 dhe 26 tetor 2010.

IV. LIGJI

Kushtet e përgjithshme të procedurës për pranueshmëri

34. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të Rregullores së vet të Punës (RrP).
35. Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave siç përcaktohet në Rregullën 25, paragrafin 1 të RrP së vet.
36. Sipas Rregullës të përmendur më lart, bazuar në konceptin e llogaridhënies në Planin Operativ (OPLAN) të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Mandati i Panelit nuk e autorizon atë që të shqyrtoj procedurat ligjore dhe vendimet e gjykatave të Kosovës. Nuk ka kompetencë as në fushën administrative e as në fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Këto janë kompetencë e vetëm e gjykatave të Kosovës. Për më tepër, Paneli tashmë ka konstatuar se fakti që gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e trupin gjykues në ndonjë gjykatë të caktuar, nuk ia humb asaj gjykate karakterin e të qenurit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (ndër të tjera, shih lëndët e PShDNJ nr. 2011-24, *Predrag Lazic*, paragrafi 20; 2011-20, *Dejan Jovanovic*, paragrafi 33).
37. Në këtë lëndë, vendimet e kontestuara nga ana e parashtruesit të ankesës ishin nxjerrë nga gjykatat e Kosovës, detyrë e të cilave ishte që të vendosin për ankesën e parashtruesit të ankesës lidhur me ligjshmërinë e veprimeve të ndërmarra dhe vendimet e nxjerra nga ana e autoriteteve ndjekëse gjatë hetimit ndaj parashtruesit të ankesës. Megjithatë, Paneli është i mendimit, për arsye të paraqitura më poshtë, se për qëllime të kësaj lënde nuk është e nevojshme të vendoset nëse karakteri i kufizuar i detyrave të ushtruara nga ana e gjykatave në këtë lëndë është e ndonjë rëndësie ligjore për të përcaktuar nëse Paneli ka kompetencë për të shqyrtuar këtë lëndë.
38. Prandaj për qëllimet e kësaj lënde Paneli do të lë të hapur pyetjen nëse ka kompetencë për të shqyrtuar akuzat në lidhje me gjykatat e Kosovës për aq sa veprimet e tyre janë të kufizuara për shqyrtimin e ligjshmërisë së veprimeve dhe vendimeve të nxjerra nga autoritetet e ndjekjes së EULEX-it në kuadër të hetimeve penale.

Përmbushja e kërkesës prej gjashtë muajsh

39. Në përputhje me Rregullën 25, paragrafi 3 i Rregullores së Punës¹ së Panelit, ankesat duhet të dorëzohen brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

¹ Siç saktësohet në versionin e datës 9 qershor 2010 në fuqi në kohën e paraqitjes së kësaj ankese.

40. Në këtë lëndë, shkeljet e pretenduara në lidhje me arrestimin dhe paraburgimin e parashtruesit të ankesës kanë filluar me 22 korrik 2010 atëherë kur parashtruesi i ankesës ishte arrestuar dhe kishte vazhduar deri në lirim të tij nga paraburgimi më 18 nëntor 2010.
41. Parashtruesi i ankesës ka parashtruar ankesën e tij me 8 korrik 2011. Në përputhje me Rregullën 25, paragrafin 3 të Rregullores së Punës, ankesa është dashur që të parashtrohej jo më vonë se data 18 maj 2011, d.m.th. gjashtë muaj nga data e lirit të tij dhe përfundimit të shkeljes së pretenduar. Prandaj kjo pjesë e ankesës nuk plotëson kriteret e pranimit të përcaktuara me Rregullën 29 të RrP së vet.
42. Rrjedhimisht, çështja e ngritur në këtë pjesë të kësaj ankese nuk bie në kuadër të mandatit të Panelit, siç saktësohet në Rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe OPLAN të EULEX-it në Kosovë.

Statusi i viktimës

43. Parashtruesi i ankesës kundërshton faktin se ZPSK në kërkesën e saj të datës 18 janar 2011, dhe gjykatësi i procedurës paraprake në vendimin e tij të së njëjtës ditë, iu ishin referuar akuzave nën pikat 6 deri në 8, pavarësisht faktit se më 22 dhe 26 tetor 2010 gjykata kishte konstatuar se nuk kishte prova të mjaftueshme për t'i mbështetur këto akuza.
44. Paneli konstaton se në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, personi nuk mund të pretendoj të jetë viktimë e një shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë sipas Nenit 6 të Konventës Evropiane të së Drejtave të Njeriut e cila dyshohet të ketë ndodhur gjatë rrjedhës së procedurave në të cilat personi më në fund ishte liruar apo ato procedura ishin ndërprerë (shih, *KEDNj, Osmanov dhe Husseinov kundër Bullgarisë* (dec.), nos. 54178/00 dhe 59901/00, 4 shtator 2003; *Witkowski kundër Polonisë* (dec.), nr. 53804/00, 3 shkurt 2003; *Oleksy kundër Polonisë* (dec); nr. 64284/01, 28 nëntor 2006).
45. Në këtë lëndë, procedurat penale kundër parashtruesit të ankesës ishin ndërprerë. Gjykata e Qarkut e Prishtinës ka konstatuar në vendimet e saj të nxjerra me 12 dhjetor 2011 dhe 11 janar 2012 se procedurat duhej të ndërpriteshin për mungesë të provave të mjaftueshme që mbështesin akuzat kundër parashtruesit të ankesës dhe për shkak se aktet e caktuara me të cilat ishte akuzuar parashtruesi i ankesës nuk përbënin vepra penale (shih paragrafët 29 deri 31 më lart).
46. Paneli konstaton se thelbi i ankesës pretendonte se kishte padrejtësi procedurale në pjesën e autoriteteve të cilët kishin zhvilluar hetimin kundër parashtruesit të ankesës. Paneli konsideron se secila mangësi procedurale që ka mundur të ndodhë gjatë hetimit duhet të konsiderohet të ketë qenë korrigjuar përmes ndërprerjes së procedurave dhe pastrimit të emrit të parashtruesit të ankesës.

47. Kështu, parashtruesi i ankesës nuk mund më të pretendoj të jetë viktimë e shkeljeve të dyshuara të të drejtave të tij për gjykim të drejtë. Rrjedhimisht, kjo çështje e ngritur në këtë pjesë të ankesës nuk bie në kuadër të mandatit të Panelit, siç saktësohet në Rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe të OPLAN të EULEX-it në Kosovë.

PËR KËTO ARSYE, Paneli njëzëri,

konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë,

gjen se ankesa është e pabazuar sipas Rregullës 29 (d) të Rregullores së vet të Punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit

